

suva



Mbulimi i sigurimit nga “Suva”

Ne ju kërkojmë që ta vendosni këtë informacion në një vend qartësisht të dukshëm për punonjësit e kompanisë tuaj.

Si punëmarrës ju duhet të jeni i informuar për këtë

Mbulimi i sigurimit

Si punëmarrës ose punëmarrëse e kësaj kompanie, ju jeni i siguruar automatikisht në "Suva" nga aksidentet dhe sëmundjet profesionale. Për shtetasit e BE-së ose shtetasit zviceranë që banojnë në BE mund të zbatohen rregulla të veçanta.

Përgjegjësi juaj i Burimeve Njerëzore do t'ju ndihmojë me kënaqësi.

Të punosh në mënyrë të sigurt

Të gjithë punëmarrësit janë të detyruar të mbështesin punëdhënësin e tyre në zbatimin e rregulloreve për sigurinë në punë. Në veçanti ju duhet të përdorni pajisje mbrojtëse personale dhe pajisjet e sigurisë në mënyrë korrekte; këto nuk mund të hiqen ose të ndryshohen pa lejen e punëdhënësit. Përveç kësaj, punëmarrësit kanë të drejtë të informohen dhe të konsultohen menjëherë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe kanë të drejtë të paraqesin propozime përpara se punëdhënësi të marrë një vendim në lidhje me sigurinë në punë.

Raportojini aksidentet sa më shpejt që të jetë e mundur

Aksidentet në punë dhe jashtë vendit të punës, si dhe sëmundjet profesionale, duhet t'i raportohen mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ose drejtuesve të kompanisë, edhe kur puna nuk duhet ndërprerë. Njoftimi me vonesë mund të çojë në uljen e pjesshme të përfitimeve të sigurimit.

Primet

Punëdhënësi paguan primet për sigurimin e detyrueshëm nga aksidentet; megjithatë, ai mund të zbresë primet për sigurimin nga aksidentet jashtë vendit të punës nga paga e punëmarrësve të tij. Punëdhënësi ose përgjegjësi juaj i Burimeve Njerëzore do të jenë të lumtur t'ju informojnë për shumën aktuale që zbritet nga paga.

Efekti i mbulimit të sigurimit

Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

Si punëmarrës ose praktikant, jeni të detyruar të siguroheni nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale gjatë veprimtarisë suaj profesionale.

Aksidentet jashtë vendit të punës

Punëmarrësit, ngarkesa javore e të cilëve me një punëdhënësin është të paktën tetë orë, duhet të jenë gjithashtu të siguruar nga aksidentet jashtë vendit të punës. Punëmarrësit me kohë të pjesshme që nuk realizojnë minimumin e tetë orëshit në javë me asnjë punëdhënësin janë të siguruar nga aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe aksidentet rrugës për në punë; ata nuk janë të siguruar nga aksidentet jashtë vendit të punës.

Kohëzgjatja e mbulimit të sigurimit


Për një të punësuar që është i siguruar nga aksidentet në punë dhe jashtë vendit të punës

- **sigurimi fillon** në ditën e fillimit të marrëdhënies së punës ose kur punëmarrësit i lind e drejta e pagës; gjithsesi, në çdo rast, në momentin kur punonjësi nisat për në punë;
- **sigurimi përfundon** në ditën e 31-të pas ditës në të cilën fitohet e drejta për të paktën gjysmën e pagës ose zëvendësimin e pagës (kompensimi ditor nga sigurimi i detyrueshëm nga aksidentet, sigurimi ushtarak, sigurimi i invaliditetit (IV) dhe ato nga kompanitë e sigurimeve shëndetësore dhe siguroesit privatë të shëndetit dhe aksidenteve që zëvendësojnë pagesën e vazhdueshme të pagës, kompensimi sipas ligjit për zëvendësimin e të ardhurave dhe kompensimi nga sigurimi kantonial i lindjes).

Për një të punësuar që është i siguruar vetëm nga

aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, sigurimi

- **fillon** me fillimin e udhëtimit për në punë dhe
- **përfundon** sapo personi i siguruar të ketë bërë udhëtimin e drejtpërdrejtë për në shtëpi pas përfundimit të punës.



Sigurimi me marrëveshje të veçantë

Kushdo që ka sigurim të detyrueshëm nga aksidentet jashtë vendit të punës mund ta zgjasë sigurimin nga jashtë vendit të punës me marrëveshje të veçantë maksimalisht për gjashtë muaj rresht. Në këtë mënyrë, mund të shmangen boshllëqet e sigurimit që lindin, për shembull, në rast të pushimeve pa pagesë ose nëse, në rast paaftësie të plotë ose të pjesshme për punë, paga ose përfitimet e zëvendësimit të pagës (kompensim ditor në rast aksidenti, sëmundjeje etj.) së bashku arrijnë në më pak se 50 për qind të pagës së fundit. Sigurimi, aktualisht 65 franga në muaj, duhet të merret jo më vonë se dita e 31-të pas ditës në të cilën mbaron e drejta për të paktën gjysmën e pagës. Këtë mund ta bëni shpejt dhe lehtë në www.suva.ch/abredeversicherung. Agjencia juaj “Suva” do të jetë e lumtur t’ju ndihmojë nëse keni ndonjë pyetje.

Sigurimi me marrëveshje të veçantë ofron të njëjtat përfitime si sigurimi i detyrueshëm i aksidenteve jashtë vendit të punës. Aksidentet pas daljes në pension (tërheqja nga tregu i punës) nuk nxisin të drejtën për kompensim ditor. Rreziku i aksidentit në punë në rast të vetëpunësimit ose punësimit nuk mbulohet nga sigurimi me marrëveshje të veçantë.

Sigurimi i sipërmarrësit

Personat e vetëpunësuar brenda zonës së përgjegjësisë së “Suva” kanë mundësinë të marrin sigurimin e sipërmarrësit (sigurim vullnetar në përputhje me ligjin për sigurimin e aksidenteve). www.suva.ch/unternehmerversicherung

Sigurimi nga aksidentet për të papunët

Personat e papunë, të cilët kanë të drejtë në përfitimin e papunësisë, kanë sigurim të detyrueshëm për aksidentet pranë “Suva”.

Përfitimet e sigurimit

Në rast aksidentesh në punë dhe sëmundjesh profesionale, punëmarrësit e siguruar në “Suva” kanë të drejtë për sa vijon:

shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe rimbursimet e kostos

- trajtim mjekësor, ambulator ose spitalor në pavijonin e përgjithshëm, me zgjedhje të lirë të mjekut, stomatologut etj.
- mjete ndihmëse që kompensojnë dëmtimin fizik ose humbjen e funksionit (p.sh. protezat)
- kompensim për dëmtimin e sendeve që zëvendësojnë një pjesë ose funksion të trupit (p.sh. protezat)
- shpenzime të pakufizuara të nevojshme mjekësore, udhëtimi, transporti dhe shpëtimi në Zvicër dhe me kufizime të caktuara jashtë vendit.

Rehabilitimi holistik

Pacientët e aksidenteve që janë lënduar rëndë dhe kanë nevojë për rehabilitim gjithëpërfshirës pas trajtimit në spitalin e kujdesit intensiv ndihmohen nga “Suva” në klinikat e saj rehabilituese në Bellikon dhe Sitten. Synimi është rikuperimi sa më i shpejtë i shëndetit dhe gjetja e rrugës së kthimit në përditshmëri dhe në punë.

Përfitimet në para

Kompensimi ditor: nga dita e 3-të pas ditës së aksidentit, 80 për qind e pagës së fundit të marrë para aksidentit, të klasifikuar sipas shkallës së paaftësisë për punë.

Pension invaliditeti: maksimumi deri në 80 për qind të pagës së siguruar, të klasifikuar sipas shkallës së invaliditetit. Kompensimet e pafuqisë gjithashtu paguhen në kushte të caktuara të përcaktuara me ligj.

Kompensimi i integritetit: pagesë që kryhet vetëm një herë për dëmtim të përhershëm dhe të rëndësishëm të integritetit fizik ose mendor si pasojë e një aksidenti ose një sëmundjeje profesionale. Kompensimi nuk mund të kalojë masën maksimale të pagës vjetore të siguruar që zbatohet në ditën e aksidentit dhe klasifikohet sipas ashpërsisë së dëmtimit të integritetit.



Pensioni i të mbijetuarve: vejushat ose vejanët marrin 40 për qind, jetimët që kanë humbur njërin prind 15 për qind, jetimët që kanë humbur të dy prindërit 25 për qind dhe bashkëshortët e divorcuar që kanë të drejtë për mbështetje marrin deri në 20 për qind të pagës së siguruar. Shuma totale e këtyre përfitimeve nuk mund të kalojë 70 për qind (90 për qind në rastin e bashkëshortëve të divorcuar me të drejtë mbështetjeje) të pagës së siguruar.

Kompensimi i inflacionit: Përfituesit e pensioneve të invaliditetit, vejushat, vejanët dhe jetimët kanë të drejtën e kompensimit të inflacionit.

Paga e fundit e marrë para aksidentit konsiderohet paga e siguruar për vlerësimin e kompensimit ditor dhe paga e marrë brenda një viti para aksidentit për vlerësimin e pensioneve. Shuma maksimale e pagës së siguruar caktohet nga Këshilli Federal.

Reduktimi i përfitimeve të sigurimit

Aksidentet në punë dhe jashtë vendit të punës mund të kenë reduktime ose refuzime të përfitimeve:

Nuk ka të drejtë të përfitojë sigurimin për dëmtimet të shkaktuara me dashje nga personi i siguruar, me përjashtim të një kontributi të parashikuar ligjërisht për shpenzimet e varrimit në rast vdekjeje.

Nëse personi i siguruar pëson një aksident gjatë kryerjes së një kundërvajtjeje ose vepre penale, përfitimet në para mund të reduktohen ose, në raste veçanërisht të rënda, të refuzohen.

Në rastet e aksidenteve jashtë vendit të punës zbatohen edhe këto:

Nëse personi i siguruar e ka shkaktuar aksidentin për shkak të pakujdesisë së rëndë, kompensimi ditor reduktohet me ligj për një periudhë maksimale prej dy vjetësh pas aksidentit.

Nëse një person i siguruar pëson një aksident për shkak se e ka ekspozuar veten ndaj një risku ose rreziku të jashtëzakonshëm, ai duhet të presë, sipas rastit, t'i mohohen të gjitha përfitimet e sigurimit ose t'i reduktohen përfitimet në para me të paktën 50 për qind.

Asistenca

Jashtë orarit të punës, asistenca është në dispozicion për raporte dëmsh dhe emergjencash në numrin e tel. 0848 724 144. www.suva.ch/assistance

Informacione të mëtejshme

Nëse dëshironi të dini më shumë, ju lutemi kontaktoni punëdhënësin ose agjencinë tuaj "Suva" (Tel. 058 411 12 12).

Modeli “Suva” Katër shtyllat



“Suva” është më shumë se një kompani sigurimesh; ajo ndërthur parandalimin, sigurimin dhe rehabilitimin



“Suva” i kthen fitimet të siguruarit në formën e primeve më të ulëta.



“Suva” menaxhohet nga partnerë socialë. Përbërja e balancuar e Këshillit “Suva”, e përbërë nga përfaqësues të punëdhënësve, punëmarrësve dhe qeverisë federalë, mundëson zgjidhje me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme.



“Suva” është e pavarur dhe nuk merr fonde publike.

Suva
Postfach, 6002 Luzern

Informacione
Tel. 041 411 12 12
kundendienst@suva.ch

Shkarko
www.suva.ch/1807.sq

Titulli
Mbulimi i sigurimit nga “Suva”

Ribotimet - përveçse për përdorim
tregtar – lejohen me kusht që të
njihet burimi.
Botimi i rishikuar: Janar 2023

Numri i publikimit
1807.sq (në dispozicion vetëm si PDF)

